

# SI TË BËHET PASHAPORTIZIMI (RESIDENZA)

Më datë **9 maj 2012** kanë hyrë në fuqi normat e reja ligjore për ndërrimin e pashaportizimit në kohë reale ("residenza in tempo reale").

Ndryshimet më kryesore që ligjvënësi ka bërë janë në lidhje me këto si më poshtë:

- a) transferim të pashaportizimit (residenza) nga një komunë në tjetrën, nga një komunë në jashtë vendit dhe anasjelltas, nga jashtë vendit në një komunë;
- b) formim i një familjeje të re apo ndryshime të ndodhura në përbërjen e saj;
- c) ndryshim adrese, nga një rrugë në një tjetër po brenda të njëjtës komunë.

## Cili është kushti kryesor

Të jetosh fizikisht (**dimora abituale**) në Komunën e Campi Bisenzio-s.

Vini re, vendbanimi që është deklaruar duhet të jetë ai ku jetoni fizikisht për një kohë të gjatë. Zhvendosjet e bëra për një kohë të shkurtër jashtë saj nuk merren për bazë. (Gjykata e Kasacionit 1965).

## Cilat janë mënyrat e aplikimit

Për të aplikuar për pashaportizim sipas njërës prej pikave të lartpërmendura a), b) e c) duhet të plotësohen disa formularë të parashikuara nga Ministria e Brendshme.

Këto formularë mund të dërgohen në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. on line, nëpërmjet faqes F.I.D.O që ka vendosur Komuna e Campi Bisenzio-s;
2. me postë rakomande në adresën e Gjendjes civile: Comune di Campi Bisenzio, Piazza Dante n. 36 CAP 50013 - CAMPI BISENZIO ( FI );
3. me fax, në numrin 055/8959446;
4. me adresë e-mail personale **të certifikuar-PEC** në atë të Komunës: [comune.campi-bisenzio@postacert.toscana.it](mailto:comune.campi-bisenzio@postacert.toscana.it) ;
5. me adresë e-mail personale **të thjeshtë** në atë të Komunës: [anagrafe@comune.campi-bisenzio.fi.it](mailto:anagrafe@comune.campi-bisenzio.fi.it) duke firmosur formularin në mënyrë digjitale ose dorazi (emër mbiemër), por në këtë rast të fundit duhet skanerizuar dhe bashkangjitur një kopje e dokumentit ID të aplikuesit.

Për më shumë informacione mbi F.I.D.O: [Canale guidato di dichiarazione di stabilita residenza - F.I.D.O.](#)

## Çfarë dokumentacioni duhet bashkangjitur

Formulari i ministrisë duhet të jetë i plotësuar me të gjitha të dhënat kryesore siç është parashikuar nga ky i fundit.

Bashkë me formularin duhet të bashkangjitet një dokument identifikimi i vlefshëm. Nëse formulari është i firmosur edhe nga familjarë të tjerë në moshë madhore, këto të fundit duhet të bashkangjitin një dokument identifikimi. Në këtë rast këshillohet të përdoret mënyra e parë on-line F.I.D.O.

Qytetari jo italian, që vjen nga një shtet tjetër, dhe do të regjistrojë familjarët e tij/saj, duhet të bashkangjisi gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të treguar lidhjen familjare, si për shembull: certifikata të përkthyer, legalizuara apo me apostile të lëshuara nga vendi ardhës sipas ligjeve në fuqi.

- Për çdo rast të caktuar qytetarët që NUK bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian duhet të bashkangjisin dokumentacionin e parashikuar nga formulari A (allegato A).
- Ndërsa qytetarët që bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian duhet të bashkangjisin dokumentacionin e parashikuar nga formulari B (allegato B).

## Koha e aplikimit dhe Kostoja

Procesi për marrjen e pashaportizimit (residenza) në një komunë është disi i ndërlikuar. Kjo do të thotë që së bashku me Zyrën e Gjendjes civile janë të angazhuara edhe disa zyra të tjera. Megjithatë, normativa e re ka munduar ta thjeshtëzojë atë sa më shumë. Kjo do të thotë që **brenda dy ditë pune** nga data e aplikimit, Zyra e Gjendjes civile bën regjistrimin e përkohshëm, **duke e filluar atë nga data e aplikimit. Më pas, brenda 45 ditëve po kjo zyrë** verifikon në bashëpunim me Policinë bashkiake (Policia Municipale) aplikuesin, nëse banon me të vërtetë në atë adresë apo jo.

Me mbylljen e 45 ditëve, nëse aplikuesit nuk i ka ardhur një letër nga kjo zyrë ku i shpjegohet përse nuk është pranuar aplikimi, do të thotë që pashaportizimi (residenza) është kryer me sukses.

Për këtë procedurë nuk është e parashikuar asnjë pagesë.

## Çfarë ndodh nëse nuk deklarohet e vërteta

Në rast kur deklaratat nuk janë të vërteta atëherë zbatohet ligji në fuqi, neni 75 dhe 76, Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 445/2000, që do të thotë heqje e çdo përfitimi që është marrë nga kjo deklaratë dhe ndjekje penale për deklarim të rremë.

Është detyrë e Zyrës të Gjendjes civile të bëjë kontrollet e nevojshme dhe sinjalizimet e duhura në Polici.

Gjithashtu, norma e re parashikon në rast mospërputhje të gjendjes aktuale të aplikuesit rikthim në gjëdjen e mëparshme të saj:

1. kur aplikohet për pashaportizim për herë të parë (me preardhje nga jashtë vendit apo i çregjistruar), do të vazhdohet me çregjistrim nga gjendja civile që nga data e aplikimit për pashaportizim nëse aplikimi nuk është i saktë.
2. kur bëhet aplikimi për pashaportizim dhe vjen nga një komunë tjetër, ose kur ka prejardhje nga jashtë Italisë, siç janë qytetarët italianë të regjistruar në A.I.R.E (A.I.R.E- Regjistri i Gjendjes civile të mbajtur nga çdo Konsullatë për qytetarët italianët që janë me pashaportizim jashtë vendit) aplikuesi do të hiqet menjëherë nga regjistrat e Gjendjes civile të mëparshme apo nga ato të A.I.R.E-s, dhe do të vazhdohet me regjistrimin në regjistrat e komunës së re ku po aplikohet, duke nisur nga data e aplikimit.
3. ose në rast ndryshimi të adresës të shtëpisë brenda të njejtës komunë, procedura është po e njëjta, aplikuesi do të regjistrohet në atë të re duke filluar nga data e aplikimit.

## Ku mund të bëhet aplikimi

Pranë Zyrës të Gjendjes Civile (Servizi Demografici)

**Ju kujtomë gjithashtu që..**

Me marrjen e pashaportizimit (residenza) janë të lidhura dhe disa detyrime të tjera.

Si për shembull:

Pagesa e plehrave, apo marrje lejeje për qarkullim me automejt në zona të ndaluara...

## Baza ligjore

- **Ligji n. 1228 datë 24 Dhjetor 1954:** Organizimi i Gjendjes Civile dhe e popullatës me

pashaportizim.

- **Dekreti i Presidentit të Republikës 30.05.1989 n. 223:** Miratimi i Regullores së re të Gjendjes Civile dhe të popullatës me pashaportizim.
- **Neni 5 i Dekretit Legjislativ 09/02/2012, n. 5,** i miratuar në L. 04/04/2012 n. 35 (Thjeshtëzim dhe Zhvillim - Pacchetto Semplificazioni e Sviluppo).
- **Neni 65 i Kodit të Administratës Digitale (CAD),** sipas Dekretit Legjislativ n. 82/2005

## **Formularët e nevojshëm**

[Modulo richiesta residenza formato .pdf](#)

[Modulo richiesta residenza formato .doc](#)

[Modulo richiesta cancellazione formato .pdf](#)

[Modulo richiesta cancellazione in formato.doc](#)

[Allegato A](#)

[Allegato B](#)

Të ardhurat vjetore për vitin 2019

[Tabella parametri 2019](#)